01 6803
2 22.07.25
PRISHTINË / A No.2

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
***Qeveria –Vlada-Government***
*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës*
*Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture*
*Ministry of Envirement, Spatial Planning and Infrasructure*
*Kabineti i Ministrit/ Kabinet Ministra/ Office of Minister*

Nr. _____ /2025

Data: 22.07.2025

Zv.Ministri i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 12 të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dlie Funksionimin e Administratës Shtetërore të Republikës së Kosovës dhe Agjencive të Pavarura ( Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.7 datë 01 mars 2019, Prishtinë ), Shtojcën 1 pika 10 të Rregullorës ( QRK) — Nr.14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në bazë të nenit 5 paragrafi 5.1,neni 15,21 të Ligjit nr. 08/L-275 për Rrugët, Ligjin Nr. 08/L-186 për rregullat e trafikut rrugor, Neni 228 “Ndalimi dhe kufizimi i trafikut në kushte të veqanta’’, Ligjin Nr.04/L-179 për Transportin Rrugor neni 47’’ Ndalimi i transportit të mallrave ‘’ , nxjerr këtë:

**VENDIM**

1. Ndalohet qarkullimi në Autoudhë, Rrugët Nacionale dhe Rajonale për të gjitha automjetet e transportit të mallrave me masë totale më të madhe se 15 T

1.1. Ndalimi sipas pikës 1 të këtij vendimi vlenë për periudhën **23.07.2025** deri më **28.07.2025**, duke filluar nga ora 11:00 deri në ora 17:00.

1.2. Në varësi prej kushteve klimatike,mund të ndryshon afati dhe koha e cekur në pikën 1.1.

2. Monitorimin e zbatimit të këtij vendimi e bënë Policia e Kosovës, Departamenti i Inspekcionit në MMPHI dhe autoritetet tjera ligjzbatuese.

3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Bazuar ne rekomandimin e Departamentit për Menaxhimin e Rrugëve pranë MMPHI-së si dhe Rekomandimin e Policisë së Kosovës për ndërmarrjen e masave me qëllim të mbrojtjes së rrugëve nga dëmtimet si rezultat i temperaturave të larta të cilat janë duke mbretëruar këto ditë.

**Hysen Durmishi**
Zv.Ministër

*Vendimi i dërgohet*

- *Kabinetit të Ministrit:*
- *Zyres së Sekretarit të Përgjithshëm;*
- *Policisë së Kosovës*
- *Arkivit të MMPHI-së*